Kronikë

Të shtënat në Malësi të Madhe/ Dy të rinjtë shkuan për të vjedhur, u kapën ‘mat’ nga 3 vëllezërit! Qëlluan me armë në ajër, shpallen në kërkim (EMRAT)

Dy të rinj kishin shkuar për të vjedhur në fshatin Gruemirë por u diktuan nga banorët.

Redaksia
2 Shkurt, 13:19 | **Përditësimi: 2 Shkurt, 17:36**

Share

MALËSI E MADHE- Detaje të reja janë zbardhur nga të ***shtënat me armë*** një natë më parë në fshatin Gruemirë në Malësi të Madhe. Policia njofton se dy të rinj, të identifikuar si Erion Vocrri dhe Rivaldo Zmijanej (Planaj) kishin shkuar për të vjedhur në fshatin Gruemirë por u diktuan nga banorët. Kanë qenë tre vëllezërit Mirsad, Besim dhe Edison Kurtaj të cilët kanë evidentuar dy të rinjtë që kishin tentuar të vidhnin në zonë dhe kanë debatuar me dy të rinjtë hajdutë.

Sipas Policisë, autorët kanë qëlluar me armë zjarri dhe janë shpallur në kërkim.

> *“Dyshohet se shkuan për të vjedhur në fshatin Gruemirë por u diktuan nga banorët, gjatë largimit qëlluan me armë zjarri në ajër, Policia zbardh ngjarjen. Identifikohen dhe shpallen në kërkim dy shtetas, të dyshuar si autorë që qëlluan me armë zjarri. Vijon puna intensive për kapjen e tyre*

LEXO EDHE:
Tentuan të vidhnin sende me vlerë në kishën e Ksamilit dhe dhunuan rojën, në pranga dy hajdutët ‘serialë’! Grabitën edhe banesa në Finiq

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Malësi e Madhe, në vijim të ngjarjes së ndodhur në fshatin Gruemirë, bazuar edhe në informacionet e siguruara nga inteligjenca policore dhe si rezultat i veprimeve të shpejta u bë e mundur zbardhja e ngjarjes, identifikimi dhe shpallja në kërkim e tyre.

U shpallën në kërkim shtetasit E. V., 22 vjeç, banues në fshatin Hot i Ri dhe R. Z(P)., 27 vjeç, banues në fshatin Shtoj i Vjetër; Nga veprimet paraprake rezulton se dy shtetasit e mësipërm dyshohet se kishin shkuar për të vjedhur në fshatin Gruemirë por janë diktuar nga tre shtetas banorë të fshatit e të cilët këta dy shtetas kanë debatuar dhe më pas gjatë largimit kanë qëlluar me armë zjarri në ajër. Vijon puna intensive për lokalizimin dhe kapjen e tyre”, njofton policia.

Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprat penale “Kanosja” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit”. Policia ka sekuestruar 4 gëzhoja në cilësinë e provës materiale, ndërsa nuk raportohet për të lënduar.

Sl.E./K.M/Shqiptarja.com

TAG: Shkodër | malesi e madhe | te shtena me armë | Mirsad Kurtaj | Besim Kurtaj | Edison Kurtaj | vjedhje | Erion Vocrri | Rivaldo Zmijanej

Komento

Komente

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Si e vlerësoni gjendjen e sigurisë në vend?

1 Shkurt, 08:43

Pozitive | Negative | I dyzuar

Lajme të tjera

Shkodër/ Kishte fshehur kokainë në dyqanin e tij, arrestohet 28 vjeçari! Dyshohet se e shiste në doza
2 Shkurt, 10:05

Të shtëna me armë zjarri në Malësi e Madhe, sekuestrohen 4 gëzhoja! Nuk raportohet për të lënduar
1 Shkurt, 22:28

Tiranë/ Vidhnin banesa dhe biznese, 2 të arrestuar, sekuestrohet një pistoletë dhe municion luftarak (Emrat)
1 Shkurt, 09:53

Tiranë/ I morën me dhunë 1 mijë euro 35-vjeçarit, një i arrestuar, tjetri në kërkim (VIDEO)
1 Shkurt, 09:13

Shkodër/ Kishin humbur në Malin e Taraboshit, FNSH gjen turistët pas dy orë kërkimi
31 Janar, 20:21

Shkodër/ Shpërthim tritoli në Iagjen ‘Rus’, hidhet në erë makina e parkuar! Merret në pyetje pronari i mjetit, hetohet për baste sportive (EMRI)
Ergys Kavaja
31 Janar, 07:58

Gjykata e Lartë rrëzon kërkesën e ish-kryebashkiakut Fran Frrokaj për pezullimin e dënimit 2.8 muaj burg
30 Janar, 16:51

Shkodër/ Prej vitesh jashtë funksionit, kryebashkiaku Beci ndjek nga afër rikonstruksionin e kolektorit! Zgjidh situatën e përmbytjeve në qendër (VIDEO)
Ergys Kavaja
30 Janar, 13:48

Qeveria mbulon shpenzimet mjekësore për shefin e kirurgjisë në QSUT Arvin Dibra! U zhyt me kokë në Bunë dhe dëmtoi qafën
29 Janar, 17:57

Arrestohet hajduti ‘serial’ i monopatinave në Tiranë! 24 vjeçari vodhi 3 copë brenda një dite
29 Janar, 13:45

Durrës/ I dënuar për tentativë vjedhjeje dhe i dyshuar për plagosje, arrestohet 28-vjeçari i kërkuar (EMRI)
29 Janar, 13:11

Shkodra me një korsi të re biçikletash, Benet Beci: Ritet siguria për qytetarët
Ergys Kavaja
29 Janar, 13:05

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje